

Prishtinë, 20 shkurt 2015
Kodi i ZRRE-së: V_712_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 22 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KQKO-së për amandamentimin e Kodit të Standardeve Elektrike datës 13 janar 2015,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015, nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** amandamentimi i dispozitave të Kodit të Standardeve Elektrike të KOSTT Sh.a.

Arsyetim


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13 janar 2015 ka pranuar Kërkesën e KQKO-së për amandamentimin e Kodit të Standardeve Elektrike. ZRRE përmes përfaqësuesit të saj në KQKO ka dhënë kontribut të vazhdueshëm dhe komente në amandamentimin e këtij kodi.
 - Duke pasur parasysh gjendjen aktuale dhe zhvillimet në Sistemin e Transmisionit, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë amandamentimin e dispozitave të Kodit të Standardeve Elektrike të vendosura si në Shtojcë.
 - Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Standardeve Elektrike do të mbesin në fuqi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.





III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar